



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN
E MJEDISIT TË KOSOVËS

KOSOVSKA AGENCIJA
ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL
PROTECTION AGENCY

**Raport i monitorimit dhe vlerësimit të gjendjes mjedisore
në deponit sanitare dhe stacionet e transferit të mbeturinave**

Hyrje

Ky raport është përgatitur në kuadër të planit të punës dhe aktiviteteve të Drejtorisë për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit për vitin 2018. Për përgatitjen e raportit janë realizuar vizita monitoruese në terren në deponit sanitare dhe stacionet e transferit të mbeturinave komunale.

Në kuadër të këtyre vizitave janë mbledhur informacione mbi gjendjen e përgjithshme operuese dhe menaxhuese dhe janë prezantuar në formë të raportit ku janë përfshirë, gjendja dhe menaxhimi i deponive dhe stacioneve të transferit të mbeturinave, të gjeturat kryesore nga monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes dhe rekomandimet.

Gjendja e deponive sanitare dhe stacioneve të transferit të mbeturinave

Nr.	1. Deponia sanitare rajonale e Pejës (Sferkë i Thatë)	
1.1	Koha e vizitës në deponim;	Vizita në deponin sanitare regjionale në Pejë (Sferkë i Thatë), u realizua me datë 12.03.2018 nga ekipi i sektorit të monitorimit në AMMK.
1.2	Karakteristikat e përgjithshme të deponis;	<ul style="list-style-type: none"> - Deponia rajonale e Pejës (Sferkë i Thatë) - Viti i ndërtimit 2001 financuar nga COPI - Jetëgjatësia: ka tejkaluar kapacitetet e deponimit! - Madhësia: 3.6 Ha - Zona me shtresë izoluese të bazës: 3 Ha - Lloji i shtresës izoluese të bazës së deponis: Gjeomembranë (HDPE) - Kapaciteti total: 500 000 m³ - Kjo deponim u shërben komunave: Pejë, Deçan, Klinë dhe Junik
1.3	Menaxhimi i deponis;	Kjo deponi menaxhohet nga N.P.L. “Ambienti” Sh.A. Pejë
1.4	Të gjeturat;	<p>Gjendja dhe menaxhimi aktual i deponis nuk është i kënaqshëm</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Përmbajtja e mbeturinave nuk verifikohet, mjeti transportues vetëm peshohet dhe shkarkohet në deponi, ➤ Nuk bëhet presimi dhe mbulimi i mbeturinave me shtresa të dheut si pasojë e makinerisë me defekte ➤ Nuk ka menaxhim të mirëfillte të zonës aktive (të hapur), ➤ Vatra zjarri janë hasur në perimetrin e deponis dhe nuk janë vërejtur masa të ndërmarra për parandalimin e këtyre zjarreve, ➤ Gypat për nxjerrjen e gazrave të deponis nuk ekzistojnë fare ose nga mosmirëmbajtja e tyre janë mbuluar me mbeturina, ➤ Brenda deponis persona të paautorizuar bëjnë klasifikimin e mbeturinave me qëllim të shitjes së tyre. ➤ Për shkak të mosfunksionimit të sistemit të pompimit për riqarkullim të ujërave të kulluara nga deponia në lagunë dhe anasjelltas kemi rrjedhë të këtyre ujërave në mënyrë të pakontrolluar nga zona e deponi, ➤ Deponimi bëhet në pjesën me mungesë të drenazhimit dhe gjeomembranës e për pasojë kemi rrjedhje të ujërave të kontaminuar jashtë zonës së deponis duke i ndotur ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësorë në zonën përreth, ➤ Rrethoja e deponis është e shkatërruar dhe ka prani të geneve endacak. Për më tepër deponia tashmë ka arritur fundin dhe ka tejkalime të kapacitetit të deponimit etj.

1.5	Rekomandimet;	<p>Rekomandojmë që në këtë deponim të ndërmirren këto veprime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të ketë mbikëqyrje rigoroze të përbërjes së mbeturinave që pranohen në deponi, • Të bëhet sa më parë zgjerimi i deponis ose të ndërtohet një deponi e re dhe deponia aktuale ti nënshtrohet procedurave të mbylljes sipas U. A. NR.08/2017 për Menaxhimin e Deponive të Mbeturinave, • Të bëhet shtrirja, presimi dhe mbulimi me rregull, • Të mirëmbahen gypat për nxjerrjen e gazrave të deponis, • Të rregullohet sistemi i pompimit të ujërave dhe të futet në funksion si dhe të eliminohen ujërat e zeza jashtë deponis, • Të largohen personat që veprojnë ilegalisht në deponi, • Të menaxhohet mirë zona aktive e shkakrimit të mbeturinave, • Të rindërtohet rrethoja e deponis, • Të bëhet dezinfektimi i deponis etj.
1.6	Foto nga deponia;	 <p>The left photograph shows a large, unmanaged waste dump with a person standing on top of the pile. The right photograph shows a muddy, rutted path through the waste with puddles and scattered debris.</p>


2. Deponia sanitare rajonale e Mitrovicës (Gërmovë)

2.1	Koha e vizitës në deponim;	Vizita në deponin sanitare rajonale në Mitrovicë (Gërmovë), u realizua me datë 07.03.2018 nga ekipi i sektorit të monitorimit në AMMK.
2.2	Karakteristikat e përgjithshme të deponis;	<ul style="list-style-type: none"> - Deponia rajonale e Mitrovicës (Gërmovë) - Viti i ndërtimit 2002 financuar nga Danida - Jetëgjatësia: 15 vjet - Madhësia: 7 Ha - Zona me shtresë izoluese të bazës: 4 Ha - Lloji i shtresës izoluese të bazës së deponis: Gjeomembranë (HDPE) - Kapaciteti total: 2000 000 m³ - Kjo deponi u shërben komunave: Mitrovicë, Vushtri dhe Skënderaj
2.3	Menaxhimi i deponis;	Kjo deponi menaxhohet nga Kompania Rajonale e Mbeturinave “Uniteti Sh.A. Mitrovicë
2.4	Të gjeturat;	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Deponia ka probleme të theksuara operacionale dhe mjedisore. ➤ Mbeturinat pranohen, por nuk kontrollohet përbërja e tyre, ➤ nuk bëhet trajtimi i ujërave të kullimit dhe reshjeve në deponi dhe ujërave në lagunë, çka si pasojë ujerat kanë rrjedhur jashtë deponis, ➤ Ka prani të personave të paautorizuar brenda deponis si dhe mungon rrethoja, ➤ Vërehet një përkushtim sa i përket kompaktimit dhe mbulimit të mbeturinave me shtresa të dheut si dhe mirëmbajtjes së gypave për nxjerrjen e gazrave të deponis, ➤ Zona aktive e deponis kërkon një menaxhim më të mirë, ➤ Gjithashtu një e metë në këtë deponi është mungesa e rrjetit elektrik gjë që paraqet probleme të theksuara për mbarëvajtjen e punëve dhe krijon vështirësi për stafin e deponis.
2.5	Rekomandimet;	<p>Rekomandojmë që në këtë deponim të ndërmerren këto veprime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i kushteve të punës në deponi, sidomos kyçja në rrjetin elektrik të bëhet sa më parë • Të ndërtohet rrethoja e deponis, • Të ketë mbikëqyrje rigoroze të përbërjes së mbeturinave që pranohen në deponi, • Të bëhet shtrirja, presimi dhe mbulimi me rregull, • Të rregullohet gjeneratori dhe të futet në funksion sistemi i pompimit të ujërave dhe të eliminohen ujërat e zeza jashtë deponis, • Të largohen personat që veprojnë ilegalisht në deponi, • Të ndërmerren masa për parandalimin e zjarreve, • Të pastrohet mbeturinat e shpërndara përreth deponis, • Të bëhet dezinfektimi i deponis etj.

2.6	Foto nga deponia;	
-----	-------------------	--

3. Deponia sanitare rajonale e Prizrenit (Landovicë)

3.1	Koha e vizitës në deponim;	Vizita në deponin sanitare rajonale në Prizren (Landovicë), u realizua me datë 12.04.2018 nga ekipi i sektorit të monitorimit në AMMK.
3.2	Karakteristikat e përgjithshme të deponis;	<ul style="list-style-type: none"> - Deponia rajonale e Prizrenit (Landovicë) - Viti i ndërtimit 2003 financuar nga KE - Fillimi i operimit: 2004 - Jetëgjatësia: 15 vite (mbyllja 2020), sipas KMDK-së deri më 2025 - Madhësia: 25 Ha - Zona me shtresë izoluese të bazës: 8 Ha - Lloji i shtresës izoluese të bazës së deponis: Gjeomembranë (HDPE), shtresë e deltinës - Kapaciteti total: 2,500, 000 m³ - Kjo deponi u shërben komunave: Prizren, Rahovec, Malishevë, Suharekë, Mmushë dhe Gjakovë.
3.3	Menaxhimi i deponis;	Kjo deponi menaxhohet nga Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A.
3.4	Të gjeturat;	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Aktivitetet rreth pranimit, deponimit, shtrirjes, presimit dhe mbulimit të mbeturinave në këtë deponi janë në një nivel relativisht të kënaqshëm, ➤ Ka probleme të theksuara me ujërat e deponis që kohë pas kohe rrjedhin jashtë si pasojë e mosfunksionimit të pompave të ujit rregullisht, ➤ Është grumbulluar një sasi e madhe e ujit në anën juglindore të deponis që ka marrë formën e një liqeni dhe ende nuk është duke u trajtuar, duke paraqitur rrezik potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore si dhe tokat përreth deponis,

		<ul style="list-style-type: none"> ➤ Sipas menaxhmentit planifikohet një zgjerim i deponis në mënyrë që të përballohet fluksi i mbeturinave që dërgohen për deponim, ➤ Në këtë deponi nuk janë vërejtur persona të paautorizuar që grumbullojnë ambalazhe plastike dhe metale.
3.5	Rekomandimet;	<p>Rekomandojmë që në këtë deponim të ndërmerren këto veprime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i kushteve të përgjithshme operuese në deponi, • Të ketë mbikëqyrje rigoroze të përbërjes së mbeturinave që pranohen në deponi, • Sistemi i pompimit të ujërave të jetë funksional vazhdimisht dhe të eliminohen ujërat e grumbulluara në formë liqeni, • Të ndërmerren masa për parandalimin e zjarreve, • Të pastrohet mbeturinat e shpërndara përreth deponis, • Të bëhet dezinfektimi i deponis etj.
3.6	Foto nga deponia;	
4. Deponia sanitare rajonale e Gjilanit (Velekincë)		
4.1	Koha e vizitës në deponim;	Vizita në deponin sanitare regjionale në Gjilan (Velekincë), u realizua me datë 09.07.2018 nga ekipi i sektorit të monitorimit në AMMK.

4.2	Karakteristikat e përgjithshme të deponis;	<ul style="list-style-type: none"> - Deponia rajonale në Gjilan (Velekincë) - Viti i ndërtimit 2005/2006 - Jetëgjatësia: 15 vjet, mbyllja 2020 - Madhësia: 12+12 Ha - Zona me shtresë izoluese të bazës: 5 Ha - Lloji i shtresës izoluese të bazës së deponis: Gjeomembranë (HDPE), shtresë e deltinës - Kapaciteti total: 1,200.000 m³ - Kjo deponi u shërben komunave: Gjilan, Kamenicë, Viti, Ferizaj, Kaçanik, Artanë dhe Shtime
4.3	Menaxhimi i deponis;	Kjo deponi menaxhohet nga Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A.
4.4	Të gjeturat;	<p>Krahasuar me vizitën paraprake janë shënuar hapa pozitiv në menaxhimin e kësaj deponie.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Gjatë vizitës monitoruese u pa që shtrirja, presimi dhe mbulimi i mbeturinave me shtresa të dheut është duke u bërë më me rregull, ➤ Trajtimi i ujerave të deponisë është në një gjendje më të mirë krahasuar me gjendjen gjat vizitave paraprake, ➤ Gjendja e gypave për nxjerrjen e gazrave nga deponia është e mire dhe janë zgjatur paralel me rritjen e lartësisë së trupit të mbeturinave të deponuara, ➤ Edhe në këtë deponi nuk bëhet një verifikim i mbeturinave që pranohen, ato thjesht peshohen dhe dërgohen për deponim, ➤ Përgjatë rrugës afër hyrjes në deponi janë vërejtur sasi të mëdha të mbeturinave kryesisht inerte, por edhe atyre të përziara të cilat janë hedhur në të dyja anët e rrugës në mënyrë ilegale, ➤ Dukuria më negative në këtë deponi është prania e personave të paautorizuar që merren me mbledhjen selektive të mbeturinave nga deponia dhe nxjerrjen e tyre jashtë për nevoja të tregtimit. Kjo dukuri shkakton shqetësim edhe për menaxhmentin e deponis, meqenëse këta persona ndezin edhe zjarre pran deponis, hedhin mbeturinat jashtë, dëmtojnë rrethojën e deponis, e gjithashtu paraqesin pengesa në operimin e mjeteve të punës në këtë deponi, duke rrezikuar edhe shkaktimin e aksidenteve të mundshme me fatalitet.
4.5	Rekomandimet;	<p>Rekomandojmë që në këtë deponim të ndërmerren këto veprime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të ngritën kushtet e përgjithshme të operimit në deponi, • Të ketë mbikëqyrje rigoroze të përbërjes së mbeturinave që pranohen në deponi, • Të vazhdohet trendi i shtrirjes, presimit dhe mbulimit me rregull me shtresa dheu, • Në mënyrë urgjente të ndërmerren veprime për largimin e personave të paautorizuar që veprojnë ilegalisht në deponi, • Të ndërmerren masa për parandalimin e zjarreve, • Të pastrohet mbeturinat e shpërndara përreth deponis, e sidomos ato përgjatë rrugës në hyrje të deponis, • Të bëhet dezinfektimi i deponis etj.

4.6	Foto nga deponia;	
-----	-------------------	--


5. Deponia sanitare komunale e Podujevës (Dumnicë)

5.1	Koha e vizitës në deponim;	Vizita në deponin sanitare komunale në Podujevë (Dumnicë), u realizua me datë 09.03.2018 nga ekipi i sektorit të monitorimit në AMMK.
5.2	Karakteristikat e përgjithshme të deponis;	<ul style="list-style-type: none"> - Deponia rajonale e Podujevë (Dumnicë) - Viti i ndërtimit 2004 financuar nga KE - Fillimi i operimit: 2005 - Jetëgjatësia: 20 vjet, mbyllja në 2025, sipas KMDK-së në 2040 - Madhësia: 5 (9) Ha - Zona me shtresë izoluese të bazës: 2.8 Ha - Lloji i shtresës izoluese të bazës së deponis: Gjeomembranë (HDPE) - Kapaciteti total: 1000 000 m³ - Kjo deponim u shërben komunës së Podujevës
5.3	Menaxhimi i deponis;	Kjo deponi menaxhohet nga Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A.
5.4	Të gjeturat;	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Nuk ka një mbikëqyrje të përmbytjes së mbeturinave, ➤ Mbulimi dhe presimi i tyre pothuajse nuk bëhet fare si dhe nuk menaxhohet mirë zona aktive (e hapur) e shkarkimit të mbeturinave, ➤ Gjithashtu, ka probleme me ujerat e drenazuara nga deponia në lagunë dhe ri pompimi nga laguna në deponi.
5.5	Rekomandimet;	<p>Rekomandojmë që në këtë deponim të ndërmerren këto veprime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i kushteve të përgjithshme operuese në deponi, • Të ketë mbikëqyrje rigorozë të përbërjes së mbeturinave që pranohen në deponi,


		<ul style="list-style-type: none"> • Të ndërmerren masa për parandalimin e rrjedhjes së ujerave nga deponia dhe laguna ne mjedisin përreth, • Të ndërmerren masa për parandalimin e zjarreve, • Të bëhet ngjeshja dhe mbulimi i rregullt i mbeturinave, • Të bëhet dezinfektimi i deponis etj.
5.6	Foto nga deponia;	


6. Deponia sanitare rajonale e Prishtinës (Mirash)


6.1	Koha e vizitës në deponim;	Vizita në deponin sanitare rajonale në Prishtinë (Mirash), u realizua me datë 05.07.2018 nga ekipi i sektorit të monitorimit në AMMK.
6.2	Karakteristikat e përgjithshme të deponis;	<ul style="list-style-type: none"> - Deponia rajonale në Prishtinë (Mirash) - Viti i ndërtimit 2004-2006 financuar nga KE - Fillimi i operimit: 2006 - Jetëgjatësia e planifikuar: 15 vjet, mbyllja 2020, sipas KMDK-së në 2026 - Madhësia: 40 Ha - Zona me shtresë izoluese të bazës: 6.8 Ha - Lloji i shtresës izoluese të bazës së deponis: Gjeomembranë (HDPE) 2.5 mm, shtresë e deltinës - Kapaciteti total: 3,500 000 m³ - Kjo deponi u shërben komunave: Prishtinë, Obiliq, Lipjan, Fushë Kosovë, Drenas dhe Graçanicë
6.3	Menaxhimi i deponis;	Kjo deponi menaxhohet nga Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A.
6.4	Të gjeturat;	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Gjate vizitës monitoruese në këtë deponi u ri konstatua një gjendje e rëndë sa i përket trajtimit të ujerave, pra mungon totalisht trajtimi i tyre sipas standardeve për deponi, ➤ Sasi të mëdha të ujerave të zeza janë grumbulluar në formë baseni duke paraqitur një rrezik të madh për ndotjen e tokës dhe ujërave nëntokësore,

		<ul style="list-style-type: none"> ➤ Edhe në këtë deponi si në gjitha të tjerat nuk verifikohet përmbajtja e mbeturinave, ato thjesht peshohen në peshore dhe dërgohen në deponim, ➤ Ka prani të madhe të qenve endacak, ➤ Janë shënuar hapa pozitiv sa i përket procesit të mbulimit me shtresa dheu të mbeturinave të cilat paraprakisht janë shtrirë dhe kompaktësuar, ➤ Ka një mirëmbajtje të gypave për nxjerrjen e gazrave nga deponia, ➤ Nuk janë vërejtur persona të paautorizuar brenda deponis.
6.5	Rekomandimet;	<p>Rekomandojmë që në këtë deponim të ndërmerren këto veprime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të ketë mbikëqyrje rigoroze të përbërjes së mbeturinave që pranohen në deponi, • Të bëhet shtrirja, presimi dhe mbulimi me rregull, • Të mirëmbahen gypat për nxjerrjen e gazrave të deponis, • Të rregullohet sistemi i pompimit të ujërave dhe të futet në funksion si dhe të eliminohen ujërat e zeza jashtë deponis të grumbulluara në formë baseni, • Të menaxhohet mirë zona aktive e shkarkimit të mbeturinave, • Të bëhet dezinfektimi i deponis etj.
6.6	Foto nga deponia;	
7. Deponia sanitare komunale në Dragash (Sharr)		
7.1	Koha e vizitës në deponim;	Vizita në deponin sanitare regjionale në Dragash (Sharr), u realizua me datë 12.04.2018 nga ekipi i sektorit të monitorimit në AMMK.

7.2	Karakteristikat e përgjithshme të deponis;	-Deponia rajonale në Dragash (Sharr) - Viti i ndërtimit 2003 - Fillimi i operimit: 2003 - Jetëgjatësia e planifikuar: 15 vjet - Madhësia: 2 Ha - Zona me shtresë izoluese të bazës: 5 Ha - Lloji i shtresës izoluese të bazës së deponis: Gjeomembranë (HDPE), shtresë e deltinës - Kapaciteti total: 50 000 m ³ - Kjo deponim i shërben komunës Dragash
7.3	Menaxhimi i deponis;	Kjo deponi menaxhohet nga Kompania Rajonale e Mbeturinave Ekoregjioni SH.A. njësia në Dragash
7.4	Të gjeturat;	Menaxhimi i kësaj deponie lë për të dëshiruar <ul style="list-style-type: none"> ➤ Nuk ka menaxhim të mirëfilltë të zonës aktive, ➤ Vetëm bëhet shkarkimi i mbeturinave dhe shtrirja e tyre, kurse mungon plotësisht ngjeshja dhe mbulimi me shtresa dheu, ➤ Mbeturina të shpërndara gjithandej në perimetrin përreth deponis, ➤ Problemi më i madh paraqitet me menaxhimin e ujerave të deponis të cilat nuk trajtohen aspak, ➤ Gypat për nxjerrjen e gazrave të deponis nuk ekzistojnë fare apo janë të mbuluar, ➤ Prania e qenve endacak është e madhe e gjithashtu janë hasur edhe mbetje të kafshëve shtëpiake në depon, ➤ Brenda deponis janë hasur persona të autorizuar nga menaxhmenti i deponis të cilët bëjnë grumbullimin e selektuar të mbeturinave dhe i transferojnë jashtë deponis për tregtim.
7.5	Rekomandimet;	Rekomandojmë që në këtë deponim të ndërmerren këto veprime: <ul style="list-style-type: none"> • Të ketë mbikëqyrje rigoroze të përbërjes së mbeturinave që pranohen në deponi, • Të bëhet shtrirja, presimi dhe mbulimi me rregull, • Të ndërmerren masa për parandalimin e zjarreve, • Të pastrohet mbeturinat e shpërndara përreth deponis, • Të sigurohen kushte për trajtimin e ujerave te deponis, • Transferimi i mbeturinave jashtë deponis të lejohet në përputhje me nenin 19 të U.A.Nr.08-2017, • Të bëhet dezinfektimi i deponis etj.

7.6	Foto nga deponia;	
8. Stacioni për transferim të mbeturinave në Gjakovë		
8.1	Koha e vizitës në stacion;	Vizita në stacionin për transferim të mbeturinave në Gjakovë u realizua me datë 15.03.2018 nga ekipi i sektorit të monitorimit në AMMK.
8.2	Karakteristikat e përgjithshme të stacionit;	<ul style="list-style-type: none"> - Ky stacion është i lokalizuar në periferi të qytetit të Gjakovës në drejtimin e rrugës Gjakovë – Prizren, - Mbeturinat nga ky stacion transferohen në deponin sanitarë në Landovicë-Prizren, - Ka një bazament prej betoni.
8.3	Menaxhimi i stacionit;	Menaxhohet nga Kompania Rajonale e Mbeturinave “Çabradi” Sh.A- Gjakovë
8.4	Të gjeturat;	<p>Gjendja në këtë stacion është shumë e rëndë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Sasia e mbeturinave prezente është shumë e madhe, ➤ Nuk ka rrethojë, zona e shkarkimit është mbuluar e tëra, dhe mbeturinat janë shpërndarë gjithandej në një perimetër të madh, duke shkaktuar një kundërmim dhe pamje të rëndë, sidomos për banorët afër, ➤ Ka rrjedhje dhe grumbullim të ujerave në tërë zonën përreth mbeturinave, ➤ Gjendjen e keqëson edhe më shumë prania e qenve endacak të cilët pos që i shpërndajnë mbeturinat paraqesin rrezik direkt për banorët, po ashtu përmes bartjes së infeksioneve, ➤ Sasia e madhe e mbeturinave të grumbulluara në stacion sipas menaxhmentit nuk është arritur të transferohet në deponi për shkak makineria transportuese është e pamjaftueshme etj.
8.5	Rekomandimet;	<p>Rekomandojmë që në këtë stacion të ndërmerren këto veprime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i kushteve të punës në stacion, • Të verifikohet përbërja e mbeturinave, • Ndërtimi sa më parë i rrethojës, si masë parandaluese për futjen e personave të paautorizuar,

		<p>shpërndarjen e mbeturinave si dhe pranin e qenve endacak,</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sa më parë të behet transferimi në deponim i mbeturinave të grumbulluara në stacion dhe ky proces të jetë i vazhdueshëm dhe të mos lejohet grumbullimi i sasive të mëdha në stacion, • Të pastrohet zona përreth prej mbeturinave, • Të eliminohen ujerat e grumbulluara, • Të bëhet dezinfektimi i hapësirave etj.
8.6	Foto nga stacioni;	
9. Stacioni për transferim të mbeturinave në Ferizaj (Gërlicë)		
9.1	Koha e vizitës në stacion;	Vizita në stacionin për transferim të mbeturinave në Ferizaj u realizua me datë 05.03.2018 nga ekipi i sektorit të monitorimit në AMMK.
9.2	Karakteristikat e përgjithshme të stacionit për transferim;	<ul style="list-style-type: none"> - Ky stacion ndodhet në fshatin Gërlicë - Ferizaj. - Sipërfaqja e shkarkimit të mbeturinave është e betonuar, - Mbeturinat nga ky stacion transferohen kryesisht në deponin sanitarë në Gjilan.
9.3	Menaxhimi i stacionit;	Ky stacion i transferimit të mbeturinave menaxhohet nga Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A.
9.4	Të gjeturat;	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Në përgjithësi kushtet operuese në këtë stacion janë të mira, ➤ Nuk ka grumbull të mbeturinave, transferimi në deponi kryhet me rregull, ➤ Mungon rrethoja e stacionit çka ka ndikua në shpërndarjen e mbeturinave në zonën përreth, ➤ Nuk ka probleme të theksuara me ujerat e zeza.
9.5	Rekomandimet;	<p>Rekomandojmë që në këtë stacion të ndërmerren këto veprime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i kushteve të punës në stacion,

		<ul style="list-style-type: none"> • Të verifikohet përbërja e mbeturinave, • Ndërtimi sa më parë i rrethojës, • Të mirëmbahet zona përreth stacionit, • Të bëhet dezinfektimi i hapësirave etj.
9.6	Foto nga stacioni;	
10. Stacioni për transferim të mbeturinave në Drenas		
10.1	Koha e vizitës në stacion;	Vizita në stacionin për transferim të mbeturinave në Drenas u realizua me datë 25.06.2018 nga ekipi i sektorit të monitorimit në AMMK.
10.2	Karakteristikat e përgjithshme të stacionit për transferim;	<ul style="list-style-type: none"> - Ky stacion ndodhet pranë minierës së Feronikelit në Drenas, - Bazamenti i stacionit është i betonuar dhe e ndarë në dy pjesë me një mur prej betoni - Mbeturinat nga ky stacion transferohen në deponin sanitarë në Mirash (Prishtinë)
10.3	Menaxhimi i stacionit;	Ky stacion për transferim të mbeturinave menaxhohet nga Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A
10.4	Të gjeturat;	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Gjatë vizitës u pa se gjendja në këtë stacion në përgjithësi është e mirë, ➤ Meqenëse zakonisht transferimi bëhet me rregull sasia e mbeturinave në bazamentin e shkarkimit është e vogël, ➤ Problematike është prania e një sasive të grumbulluar të ujerave të zeza e cila duhet të trajtohet dhe të eliminohet në mënyrë që të shmangët rrjedhja jashtë zonës së stacionit, me ç'rast do të ndoten tokat dhe uji në Lumin Drenica i cili ndodhet shumë afër.
10.5	Rekomandimet;	<p>Rekomandojmë që në këtë stacion të ndërmerren këto veprime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i kushteve të punës në stacion, • Të verifikohet përbërja e mbeturinave,

		<ul style="list-style-type: none">• Transferimi i mbeturinave të bëhet në mënyrë të vazhdueshme,• Të eliminohen ujerat e grumbulluara,• Të bëhet dezinfektimi i hapësirave etj.
10.6	Foto nga stacioni;	